



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr.20, datë 25.06.2020

**Për autorizimin e Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit
për fillimin e procedurave për përzgjedhjen e
bankave agjente në listën paraprake**

Në mbështetje të nenit 42, pika 7 të ligjit nr. 53/2014 “Për sigurimin e depozitave” të ndryshuar, të 22, pika 1, nenit 23, pika 1, nenit 24, pika 2 dhe nenit 25, pika 6 të rregullores “Për kompensimin e depozitave të siguruara” të miratuar me Urdhërin e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë nr. prot 3762, datë 18.07.2016, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Të autorizojë Komisionin e Përhershëm të Vlerësimit, të krijuar me Vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë nr.6, datë 30.3.2017, për fillimin e procedurave për përzgjedhjen e bankave agjente në listën paraprake.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Komisioni i Përhershëm i Vlerësimit të Bankave Agjente.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar